

KONTRATË

E lidhur në Gjakovë, me dt.20.11.2018, në mes të :

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoritetit Kontraktues)
dhe

NTSH "Marash-Shped" shpk & "EUROCOM" shpk – Gjakovë, me nr.biznesit 70232350 & 70481414 (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi)

të cilët janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS –“ Rivitalizimi i interierit në Shtëpinë e Kulturës në fsh.Bishtazhin dhe instalimi elektrik, instalimi I kamerave të sigurisë dhe lyerja në Muzeun Etnografik”

Numri i identifikimit – 632-18-081-536/Loti I & II

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Rivitalizimi i interierit në Shtëpinë e Kulturës në fsh.Bishtazhin- loti I-rë dhe Instalimi elektrik, instalimi I kamerave të sigurisë dhe lyerja në Muzeun Etnografik – loti II-të**, për Autoritetin kontraktues, sipas specifikave të dhëna nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si vijon:
- 1.2 Kontraktuesi duhet të kryej punët në pajtushmëri të plotë me Kushtet e kontratës , specifikimet e detyrueshme teknike dhe paramasën me paralogari.
- 1.3 Kontrata do të nënshkruhet me **dt.20.11.2017**.
- 1.4 Kryerja e punëve do të filloj pas urdhëresës me shkrim të Menaxherit të projektit dhe do të përfundoj brenda **13 dite** .

1.5 Vendi i ekzekutimit të punëve është në **Shtëpinë e Kulturës në fsh. Bishtazhin- loti I-rë dhe në Muzeun Etnografik – loti II-të në Gjakovë.**

1.6 Mbikëqyerja dhe pranimi i punimeve do të bëhet nga Komisioni për mbikëqyerje të punimeve :

- a) Shkelzen Rruka, koordinator për punë teknike në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi”;
- b) Petrit Bakalli, skenograf në Teatrin e Qytetit “Hadi Shehu”;
- c) Memli Doli, koordinator për Veprimtari Amatore në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi” .

1.7 Menaxher i projektit është Besmir Hasi, drejtor i Muzeve të Qytetit, mob.049/920-832. Menaxheri i Projektit është personi përgjegjës që do të përcjellë implementimin e kontratës, kualitetin e punëve dhe njëherit do të bëjë vlerësimin e punëve të realizuara. Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës bashkë me Tvsh është :

Loti I-rë - 4.990,00€ (katërmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë euro);

Loti II-të - 4.920,00€ (katërmijë e nëntëqind e njëzetë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat do të kryhen pas dorëzimit të **procesit të pranimit të punimeve dhe faturës.**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.3 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *te kryej ndonjë ose te gjitha punët* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *punëve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14**Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Albert Bala	Emri:	Komuna e Gjakovës - Albana Bakalli
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxhere e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.11.2018	Data:	20.11.2018
Vula:		Vula:	



SHTËPIA E KULTURËS NË BISHTAZHIN**PARAMASA DHE PARALLOGARIA****PUNËT NË INTERIERIN E BRENDSHËM TË SHTËPISË SË KULTURËS NË BISHTAZHIN**

Për secilin pozicion parashihet blerja dhe sigurimi i materialit, ekzekutimi i punimeve si në përshkrimin e dhënë në pozicion, ashtu që pozicionet të kenë standarde dhe të sillen në gjendje funksionaliteti si dhe sigurimi i atesteve të nevojshme për materialin e përdorur. Te gjitha produktet e cekura më poshtë mund të zëvendësohen me produkte tjera të cilësisë së njëjtë dhe që i plotësojnë kushtet teknike. Duhet të marrën parasysh dimensionet e dyerve në projekt për futjen e pajisjeve të ndryshme ne objekt. Punëmarrësi është i detyruar që të bëjë punët përgatitore para fillimit të punimeve si dhe të bëjë incizimin e terrenit.

Nr. Art.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH
RIVITALIZIMI I INTERIERIT					
1	PUNËT E KARRIGEVE				
1.1	Furnizimi dhe montimi i karrigeve për Shtëpinë e Kulturës në fsh. Bishtazhin. Karriget duhen të jenë të përforcuara nga konstruksioni metalik të cilat lidhen në dyshtemenë me bulona përkatës ose mjete të ngjashme dhe të përshtatshme për këtë qëllim, gjithashtu karriget duhet të jenë për nga 5 copë në rende si dhe ato duhet jenë të fiksuara në konstruksion metalik, të përshtatshme për kësi lloji veprimtarie, si dhe duhen të jenë me sistem kiper të ngritjes me mekanizëm të përshtatshëm kur nuk janë të ulur pjesëmarrësit, ulësja duhet të ketë pozitë vertikale. Llogaria në copë për karrige.	copë	63.00	60.00	3,780.00
Gjithsej totali me TVSH - INSTALIMET E PANELEVE SHPËRNDARËSE					3,780.00



2	PUNËT E PERDEVE				
2.1	Furnizim dhe montimi i perdeve të prapaskenave, për programe kulturore dhe sportive. Perdet duhen të jenë me mekanizëm të përshtatshëm për hapje dhe mbyllje me litarë duke përfshirë edhe pjesën mbajtëse metalike të perdes. Llogaria në m2 të perdeve.	m ²	15	20.00	300.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E PERDEVE					300.00



3	PUNËT E TEPIHSONIT				
3.1	Furnizimi, transportimi, montimi i Tepihsonit adekuat për bina (skena) i cili duhet të jetë më trashësi të t=4.0 mm, i cili duhet të ngjitet me ngjitëse në dysheme me material prej dërrasë me ngjitëse adekuate. Tepisoni duhet të jetë rrezistent ndaj zjarrit (B1)Llogaria në m2 të tepihsonit.	m ²	35	26.00	910.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E TEPIHSONIT					910.00

R E K A P I T U L I M I SHTËPISË SË KULTURËS NË BISHTAZHIN		
1	PUNËT E KARRIGEVE	3,780.00
2	PUNËT E PERDEVE	300.00
3	PUNËT E TEPIHSONIT	910.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT NË INTERIERIN E BRENDSHËM TË SHTËPISË SË KULTURËS NË BISHTAZHIN		4,990.00



MUZEU ETNOGRAFIK

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE

Per secilin pozicion parashifet blerja dhe sigurimi I materialit,ekzekutimi I punimeve si ne pershkrimin e dhene ne pozicion, ashtu qe pozicionet te kene standarte dhe te sillen ne gjendje funksionaliteti si dhe sigurimi i atesteve te nevojshme per materialin e perdorur. Te gjitha produktet e cekura me poshte mund te zevendesohen me produkte tjera te cilesise se njejte dhe qe i plotesojne kushtet teknike. Duhet te mirren parasyshe dimenzionet e dyreve ne projekt per futjen paisje te ndryshme ne objekt. Per secilen pune dhe material te vendosur ne objekt duhet te kete kujdes te shtuar. Sepse objekti eshte nen mbrojtjen e Institutit te Kosoves per trashegimise kulturore.

Nr. Art.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH
1	INSTALIMET E PANELEVE SHPËRNDARËSE				
1.3	Shirit te bakrit 20x3mm	m`	6.00	1.00	6.00
1.4	Sigurese trefazore katerpolare AS 100A	copë	1.00	5.00	5.00
1.7	Nderpreres Transferues Automatik 100A, 400V, 50Hz, 4p	copë	1.00	15.00	15.00
1.8	Leshues te mbitensionit konform IEC61643-1, 15kA, 30/315mS	copë	3.00	30.00	90.00
1.10	Siguresa trepolare gjysmeautomatike C63A, 3p	copë	2.00	8.00	16.00
1.11	Siguresa trepolare gjysmeautomatike C32A, 3p	copë	2.00	8.00	16.00
1.12	Siguresa gjysmeautomatike B6A, 1p	copë	1.00	8.00	8.00
1.13	Nderpreres gungor BS 16-90	copë	1.00	1.00	1.00
1.14	Komplet me pjeset ndihmese dhe elementet e paspecifikuara me 30% rezerve.	copë	1.00	20.00	20.00
1.15	Rele diferenciale - FIDA 63/0,3A, 4p	copë	3.00	12.00	36.00
1.16	Siguresa gjysmeautomatike C25A,3p	copë	2.00	11.00	22.00
1.17	Siguresa gjysmeautomatike C16A,3p	copë	1.00	11.00	11.00
1.18	Siguresa gjysmeautomatike C16A,1p	copë	31.00	10.00	310.00
1.19	Siguresa gjysmeautomatike B10A,1p	copë	7.00	10.00	70.00
1.20	Indikatore te fazeve	copë	3.00	5.00	15.00
1.21	Material I imët	paushall	1.00	319.00	319.00
Gjithsej totali me TVSH - INSTALIMET E PANELEVE SHPËRNDARËSE					960.00



2	INSTALIMET I KAMERAVE				
2.1	Furnizimi me kamera me detektim levizes per ambiente te jashtme. Kamera duhet te jep 30 imazhe ne sekond me mikrofon te integruar me rezulucion minimal 1920 x 1080 dhe kend te shikimit minimal 85°. Prej 2.0 - 4.0 mega pixel .	copë	10	100.00	1,000.00
2.2	Furnizimi I video rekorderit me 16 kanale. SATA Ports, me 8TB kapacitetin per disk. 1Kbps ~ 6144Kbps per kanal. Paisja duhet te lidhet me program qe duhet per transmetimin e kamerave	cope	1	200.00	200.00
2.3	Furnizimi me kablo per kamera deri te paisja kompjuterike. Te parashihen te gjitha pjeset percellese te lidhjeve, mbajtesve deri ne funksionalizim te paisjeve.	m'	500	0.50	250.00
2.4	Furnizimi me gyp te kablos per kamera deri te paisja kompjuterike. Te parashihen te gjitha pjeset percellese te lidhjeve deri ne funksionalizim te paisjeve.	m'	200	0.30	60.00
2.5	Hapja e kanaleve ne oborr te Muzeut per futjen e kablllove. Kabllot duhet te futen ne toke me bari dhe ne disa pjese me fure me cemento. Duhet te parashihet rregullimi I dheut me bari si dhe gureve me cemento.	m'	200	2.00	400.00
Per secilen pune dhe material te vendosur ne objekt duhet te kete kujdes te shtuar. Sepse objekti eshte nen mbrojtjen e Institutit te Kosoves per trashegimise kulturore.					
Gjithsej totali me TVSH - INSTALIMET I KAMERAVE					1,910.00



3 PUNET E LYRJEVE					
3.1	Furnizimi me material dhe ljerja e mureve te muzeut me ngjyre akrile ne katin perdhese. Ngjyra duhet te jete e bardhe dhe te lyhet dy here. Se pari duhet te lyhet me ngjyre bazike, shtresa e pare duhet te lyhet te lihet te thahet pastaj te lyhet shtresa e dyte. Pjeset e drurit te objektit duhet te mbulohet dhe te mbrohen nga ngjyra, gjate punes: plafone, dritare dhe pjeset tjera te enterierit jane ne mbrojtje nga IKMM.	m ²	160	5.00	800.00
3.2	Furnizimi me material dhe ljerja e mureve te muzeut me ngjyre akrile ne katin 1. Ngjyra duhet te jete e bardhe dhe te lyhet dy here. Shtresa e pare duhet te lyhet te lihet te thahet pastaj te lyhet shtresa e dyte. Pjeset e drurit te objektit duhet te mbulohet dhe te mbrohen nga ngjyra, gjate punes: plafone, dritare dhe pjeset tjera te enterierit jane ne mbrojtje nga IKMM.	m ²	250	5.00	1,250.00
Per secilen pune dhe material te vendosur ne objekt duhet te kete kujdes te shtuar. Sepse objekti eshte nen mbrojtjen e Institutit te Kosoves per mbrojtjen e monumenteve.					
Gjithsej totali me TVSH - PUNET E LYRJEVE					2,050.00

REKAPITULIMI MUZEU ETNOGRAFIK		
1	INSTALIMET E PANELEVE SHPËRNDARËSE	960.00
2	INSTALIMET I KAMERAVE	1,910.00
3	PUNET E LYRJEVE	2,050.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNIMET NDËRTIMORE DHE ZEJTARE		4,920.00




PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	n.t.sh marash shped Sh.P.K
Adresa	Rr UÇK nr 8””
Qyteti	GJAKOVE
Kodi Postar	50000
Kontakti	ALBERT BALA
Telefoni	045230 702
Fax	
E-mail	marashshped.ks@gmail.com
Numri i TVSH	


BANKA	
Emri	NLB Prishtinë
Adresa	“N.Terezë
Qyteti	Gjakovë
Kodi Postar	50000
Shteti	Republika e Kosovës
Llogaria Bankare	1716200016069735
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)



NLB Banka
Ekspozitura Gjakovë - Shifra 273



DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)



SH.P.K.

MSH

Marash-Shped

600526315

GJAKOVË